

V E N D I M
Nr. 93, datë 21.3.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË
CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RROGOZHINË-LUSHNJË NË
TERRITORIN E QARQEVE TIRANË DHE FIER**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrogozhinë-Lushnjë në territorin e qarqeve Tiranë dhe Fier.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe të përgjithshme 122 567 m2 tokë/arë, 1820 m2 truall ndërtimi, 100 m2 ndërtesë, 94 m2 pikë servisi dhe lavazh, 70 m2 lokal shërbimi (restorant), shesh prodhim blloqesh dhe muri rrethues, me vlerë 528 368 lekë, 1573 m2 kulturë bujqësore. Vlera e përgjithshme për këtë shpronësim të jetë në shumën prej 101 897 074 (njëqind e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekësh.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 1 156 600 (një milion e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) lekësh.
 5. Fondi prej 101 897 074 (njëqind e një milion e tetëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e katër) lekësh për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzimet procedurale, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohen nga Buxheti i Shtetit i vitit 2002 në zërin "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit.
 6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 30.5.2002.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Shih tabelat B1, B2, B3, B4, B5, B6, B7